



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 5122 / 10 prot.

Pogradec, më 20, 12, 2023

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Z. MANJOLA KAMOLLI
KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për:

“PËR VËNIEN NË PËRDORIM TË SIPËRFAQES SË TOKËS NË PRONËSI TË BASHKISË POGRADEC ME NR: PASURIE 169/6, ZK 1903, ISH GUROJA E VJETËR MBI FHSATIN GURAS PËR NDËRTIMIN E VËND DEPOZITIMI TË PËRKOHSHËM TË MBETJEVE INERTE”.

Me respekt,

KRYETARI

Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 1 (Një)

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2 (Dy)

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 8(Tetë)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ .2023

PROJEKT – VENDIM
NR. _____, DATË ____ . ____ .2023

**PËR
PËR VËNIEN NË PËRDORIM TË SIPËRFAQES SË TOKËS NË PRONËSI
TË BASHKISË POGRADEC ME NR: PASURIE 169/6, ZK 1903, ISH
GUROJA E VJETËR MBI FHSATIN GURAS PËR NDËRTIMIN E VËND
DEPOZITIMI TË PËRKOHSHËM TË MBETJEVE INERTE.**

Në mbështetje të; Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, pika 10, nenit 23, gjurmën k), neni 54 të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 21 të VKM-së nr. 575, datë 24.6.2015, "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", VKM-së nr. 418, datë 27/05/2020, "Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020–2035" dhe neni 21 të Rregullores së Planit kombëtar sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 1, datë 13/01/2020, si dhe bazuar në relacioni i paraqitur dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI I BASHKISË

VENDOSI :

1. Të miratojë vëndndodhjen e vend depozitimit të përkohshëm për mbetjet inerte në vendin e cilësuar "Ish-gurorja mbi fshatin Guras".
2. Të verë në dispozicion për vënie në funksionim të këtij vend depozitimi të përkohshëm të mbetjeve inerte sipërfaqen e tokës në pronësi të Bashkisë Pogradec me nr. Pasurie 169/6, ZK 1903.
3. Administrata e Bashkisë të ndjekë procedurat ligjore për marrjen e lejavë/autorizimeve përkatëse në insitucionet përgjegjëse për ndërtimin dhe operimin e këtij vend depozitimi si dhe të pregatisë analizat tekniko ekonomike përkatëse për të propozuar në Këshill të Bashkisë formën e operimit të këtij shërbimi dhe tarifën që do aplikohet.
4. Për zbatim të këtij vendimi, ngarkohen Kryetari i Bashkisë dhe administrata e Bashkisë Pogradec.
5. Vendimi hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

K R Y E T A R E

Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

DREJTORIA E EMERGJENCAVE, STREHIMIT DHE ADMINISTRIMIT TOKES BUJQESORE NE NJESITE ADMINISTRATIVE
SEKTORI TRAJTIMIT TITUJVE PRONESISE DHE SHPRONESIMEVE

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____.2023

RELACION PËR PROJEKT VENDIMIN

**PËR VËNIEN NË PËRDORIM TË SIPËRFAQES SË TOKËS NË PRONËSI
TË BASHKISË POGRADEC ME NR: PASURIE 169/6, ZK 1903, ISH
GUROJA E VJETËR MBI FHSATIN GURAS PËR NDËRTIMIN E VËND
DEPOZITIMI TË PËRKOHSHËM TË MBETJEVE INERTE.**

TË NDERUAR KËSHILLTARË !

Projekt vendimi I cili paraqitet përpara jush është në zbatim dhe përputhje të plotë të pikës 10, neni 23, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeversijen Vendore" I ndryshuar pasi kjo dispozitë parashikon në mënyrë taksative: "...***bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për:...***10. ***Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.***". Gjithashtu edhe VKM-ja nr. 575, datë 24/06/2015, "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte" në pikën 13, parashikon detyrimin e bashkive për të miratuar vënd depozitimet e mbetjeve inerte.

Për këtë qëllim, duke u nisur edhe nga emergjenca e evidentuar në studime të miratuara tashmë nga Bashkia, është marrë prej disa kohësh nisma për ngritjen e një vënd depozitimi të mbetjeve inerte në territorin e Bashkisë Pogradec. Problematika e mbetjeve inerte është tepër shqetësuese pasi sot nuk ka një vënd të përcaktuar për depozitim të tyre dhe nga ana tjetër depozitimi I tyre në vënd depozitim rajonal të mbetjeve urbane është I ndaluar me ligj. Sot Bashkia Pogradec përballet me vështirësinë praktike pasi edhe për punimet publike në infrastrukturë nuk kemi një vënd depozitim të mbetjeve inerte.

Ndërkohë, në dokumentin e politikave të miratuara me VKM nr. 418, datë 27/05/2020, "**Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020–2035**", parashikon që bashkitë duhet të ngrejne vënd depozitime për mbetjet inerte të përkohshme deri në ngritjen e vënd depozitimeve në nivel zone menaxhimi të mbetjeve.

Parashikojmë që vënd depozitimi I përkohshëm (me jo më shumë se 3.500 ton mbetje të depozituara në vit, VKM 575, pika 14), të kryejë procesin e riciklimit, ripërdorimit nëpërmjet fraksionimit të mbetjeve inert edhe sasia e pamundur për tu ripërdorur, e cila do depozitohet do të jetë shumë më e ulët se 3.500 ton në vit. Kjo mënyrë është rekomanduar edhe nga aktet e mësipërme ligjore dhe dokumentat e politikave të përmendura.

Duke qënë se për të përcaktuar sasinë e mundshme për tu ricikluar/ripërdorur, kërkohet një analizë e detajuar financiare dhe teknike si dher njëkohësisht ndërtimi I këtij vënd depozitimi kërkon miratimin paraprak të lejava/autorizimeve mjedisore, propozojmë që këshilli të verë në dispozicion pronën e Bashkisë Pogradec mr nr. Pasurie 169/6, ZK 1903, ish-gurorja mbi fshatin Guras, si akt I nevojshëm për fillimin e procedurave për marrjen e lejeve dhe autorizimeve.

Ndërkohë paralelisht bashkia do përgatitë dhe analizën teknike dhe financiare për ti propozuar këshillit:

- Mënyrën e operimit të vënd depozitimit të mbetjeve inerte (me sipërmarrje ose nga vetë Bashkia).
- Nivelin e tarifës që do paguhet për ton mbetje të depozituara.

Për më tepër informacion teknik, po ju bashkangjisim materialin e përgatitur nga ekspertët dhe grupi I punës për këtë qëllim.

Duke qënë të hapur për cdo sqarim osë saktësim që mund të keni të nevojshëm, ju ftojme në votim.

Ju faleminderit!

Konceptoi: Erjon VESHO

Nexhmi TORRA

Miratoi: Dritan BABASULI

**KRYETAR
ILIR XHAKOLLI**

LENDJA POUK...

NR. 3729/1

DAT 12 10 2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
DREJTORIA E EKONOMISË QARKULLUESE

Mjedisi
SEK. MOHITAVE
2023

Nr. 5647/1 prot.

Tiranë, më 11.10.2023

Lënda: Kthim përgjigje

Drejtuar:

BASHKISË POGRADEC
Bulevardi "Reshit Collaku", Lagja Nr.2



Referuar shkresës suaj, protokolluar me tonën me Nr.5647 Prot, datë 14.09.2023 me lëndë: "Kërkesë për bashkëpunim dhe mbështetje" për përcaktimin e një vendi për funksionimin e landfillit për mbetjet inerte në territorin e Bashkisë Pogradec si dhe ekspertizën për procedurat ligjore ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte" në Nenin 21 citohet: "Njësitë e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën publike, duhet të përcaktojnë vendet përkatëse për venddepozitimet e përkohshme dhe landfilllet për trajtimin e mbetjeve inerte"

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka fushë përgjegjësie për përcaktimin e venddepozitimeve të mbetjeve inerte por ajo ndjek dhe shqyrton dokumentacionet e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis sipas Ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 "Për përvlerësimin e Ndikimit në Mjedis" nëpërmjet Agjencisë Kombëtare e Mjedisit.

Projekti i propozuar nga ana juaj duhet të jetë në përputhje me Planin Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta të miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.1, datë 13.01.2020

Bashkëlidhur kësaj shkrese ju do të gjeni edhe procedurën e cila duhet të zbatohet në kushtet kur aktiviteti është subjekt i kërkesave të Ligjit 10440, datë 7.7.2011, "Për përvlerësimin e Ndikimit në Mjedis" të ndryshuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRCJITHSHËM

Ledina BEQIRAJ AGALLIU





Relacion shpjegues.

Referuar kërkesës tuaj ku zhvilluesi që synon të zbatojë një projekt, i cili është subjekt i kërkesave të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar, i nënshtrohet procedurës sipas: Shtojca I dhe II në varësi të kapacitetit dhe metodës së trajtimit, dhe sipas VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar,

SHTOJCA I

PROJEKTET QË I NËNSHTROHEN PROCEDURËS SË THELLUAR TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

9. Instalime për asgjësimin e mbetjeve për incinerimin, trajtimin kimik, sipas seksionit D9, ose venddepozitimet e mbetjeve të rrezikshme, siç përcaktohet në ligjin “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

10. Instalime për asgjësimin e mbetjeve, për incinerimin, trajtimin kimik, sipas seksionit D9, të mbetjeve jo të rrezikshme me një kapacitet mbi 50 tonë në ditë, sikurse përcaktohet në ligjin “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

SHTOJCA II

PROJEKTET QË I NËNSHTROHEN PROCEDURËS PARAPRAKE TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

11. Projekte të tjera

b) Instalimet për asgjësimin e mbetjeve (projekte të cilat nuk përfshihen në shtojcën I);

Pas pajisjes me vendim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) paraprak ose kopje të deklaratës së ministrit për VNM-në e thelluar, të shoqëruar me raportin paraprak ose të thelluar të VNM-së operatori aplikon për Leje Mjedisit sipas procedurës së përcaktuar në VKM Nr.419/2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisit të tipave A dhe B, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja” i ndryshuar.

Aplikimi kryhet sipas KREU III "Procedurat për shqyrtimin e kërkesave dhe përcaktimi i kushteve për Leje Mjedisit Tipi B"



Referuar veprimtarisë që do të zhvillojë dhe kërkon të pajiset me Leje Mjedisi operatori duhet të aplikojë për veprimtarinë me ID 5.2/b Lendfill i mbetjeve inerte. Të gjitha Instalimet

Operatori i dërgon Agjencisë Kombëtare të Mjedisit nëpërmjet sistemit on-line, e-albania kërkesën, nëpërmjet QKB-së, referuar Ligjit Nr. 10081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Kërkuesi që aplikon pranë QKB-së për pajisjen me leje mjedisi të tipit B duhet të dorëzojë këto dokumente:

a) Formularin informues për pajisje me leje mjedisi të tipit B, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) Mandatpagesën për tarifën përkatëse për lejen e mjedisit të tipit B, sipas nenit 25 të ligjit nr.10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”;

c) Çdo informacion tjetër që kërkuesi i lejes kërkon të merret parasysh gjatë shqyrtimit të aplikimit; (dokumenta provues mbi deklaratimet e bëra në kërkesën për leje mjedisi. psh. Vendime MIE, VKB, Projekti i funksionimit të instalimit, etj.)

ç) Kopjen e vendimit të AKM-së për VNM-në paraprake ose kopje të deklaratës së ministrit për VNM-në e thelluar, të shoqëruar me raportin paraprak ose të thelluar të VNM-së, në rastet kur për instalimin është kryer procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas përcaktimit në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

d) Raportin mbi sigurinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e rreziqeve nga aksidentet madhore, kur kërkohet.

dh) Relacionin rreth dëgjësës me publikun, sipas përcaktimit në pikën 13 të kreut V të këtij vendimi (Dëgjesa me publikun zhvillohet sipas përcaktimeve të VKM Nr.247/2014 Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”, Ligjit 10440/2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” i ndryshuar me Ekspert Mjedisi të certifikuar”

Të gjitha deklaratimet e operatorit të shoqërohen me dokumente provuese.